



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 323 Akti

Nr. 433 Vendimi
Tiranë, më 03.09.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Etleđa Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 03.09.2021, ora 09:45, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sali Hasa**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Sali Hasa, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket

rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimin, z. Sali Hasa, i cili nuk ushtroi të drejtën për t'u paraqitur në seancën dëgjimore publike,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimin, z. Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është subjekt i rivlerësimin që i nënshtrohet rivlerësimin *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 12.11.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimin, z. Sali Hasa, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimin nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Firdes Shuli dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimin për subjektin e rivlerësimin, z. Sali Hasa.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimin, z. Sali Hasa, nisi procesi i rivlerësimin dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimin të pasurisë për subjektin e rivlerësimin, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimin deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimin dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 12.11.2019, e ILDKPKI-së, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimin, z. Sali Hasa.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimin, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimin ka kontakte të papërshtatshme me

personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

10. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pranë KPK.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë në datën 30.06.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për një nga tri kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për kriterin e pasurisë, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 30.06.2021 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti u njoh në rrugë zyrtare (njoftim me postë), me aktet e dosjes dhe ushtrori të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave 26.8.2021.

14. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 30.8.2021, vendosi të riftojë z. Sali Hasa në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, seancë e cila do zhvillohej më datë 1.9.2021.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit, z. Sali Hasa, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë nga IEVP “Jordan Misja” Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 30.8.2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 1.9.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 31.8.2021, të IEVP-së “Jordan Misja”, Tiranë, në përgjigje të shkresës me nr. *** prot., datë 30.8.2021, me kërkesë për shoqërimin e z. Sali Hasa në seancë dëgjimore të datës 1.9.2021, u shpreh se nuk do të paraqitej për shkak të mospasjes së veshjes së përshtatshme dhe kushteve në të cilat ndodhej.

18. Komisioni mori në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti me shkresën e datës 26.8.2021.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Sali Hasa ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

24. Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Sali Hasa, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

25. Z. Sali Hasa është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004, me nr. indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si vijon:

- DPV-në e vitit 2004;
- DPV-të për vitet 2005 – 2017;
- deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik dhe me shkresë;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

27. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sali Hasa, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* me nr. indeksi *** datë 27.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2004 – 2017, në raport me të dhënat e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*;

- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

28. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

1. Apartament në Kavajë

ILDKPKI-ja ka konstatuar se konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja. Apartamenti është shitur.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 1.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se në vitin 1992 ka privatizuar nga Ndërmarrja Komunale Banesa K një apartament 1+1, lagjja nr. ***, K. Vlera e privatizimit është deklaruar për shumën 13.268 lekë. Pjesa takuese e subjektit: 100%.
- 1.2** Subjekti ka deklaruar për këtë pasuri se i është shitur më pas shtetasit A.Xh për shumën 1.500.000 lekë (më 20.1.1998).
- 1.3** Gjatë hetimit rezultoi se me kontratën e shitblerjes, nënshkruar në datën 17.11.1993, subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin nr. ***, i përbërë nga 1 dhomë dhe 1 kuzhinë, në qytetin e K. Palë shitëse e kësaj pasurie rezultoi Ndërmarrja Komunale K, me vlerë shitje në shumën 13.268 lekë. Kjo vlerë, sipas kontratës, rezultoi e paguar në momentin e nënshkrimit të saj. Këtë pasuri subjekti e ka pasur me qira nga Ndërmarrja Komunale K, deri në momentin e blerjes së saj.
- 1.4** Sipas vërtetimit regjistrimit, lëshuar më 17.11.1993, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur apartament në lagjen nr. ***, banesa nr. ***, kati ***.
- 1.5** Bazuar në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.1.1998, rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë pasuri te pala blerëse A.Xh. Çmimi i shitjes së apartamentit është caktuar në shumën 1.500.000 lekë, vlerë e cila sipas kontratës është likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës në shumën 1.000.000 lekë dhe pjesa tjetër 500.000 lekë do të likuideohej brenda 10 ditëve, jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, palët kanë caktuar lirimin e kësaj banese nga subjekti i rivlerësimit dhe dorëzimin te blerësi më datë 1.5.1998.
- 1.6** ZVRPP-ja Kavajë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur në bashkëpronësi pasurinë apartament me sip. 59 m², e përfituar sipas kontratës së privatizimit dhe më pas e kanë shitur sipas kontratës më 20.1.1998.
- 1.7** Lidhur me këtë pasuri rezultoi edhe një deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.1.1998, e subjektit të rivlerësimit dhe palës blerëse A.Xh, të cilët deklarojnë se kanë likuiduar mes tyre edhe shumën 500.000 lekë për blerjen e banesës.
- 1.8** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri dhe shpenzimet dhe të ardhurat e përfituara nga shitblerja e kësaj pasurie apartament janë përfshirë në analizën financiare¹.

¹Shihni analizën financiare për periudhën deri në vitin 2003.

2. Truall me sip. 500 m² dhe banesë me sip. 130 m², në Kavajë

2.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar truall me sip. 500 m² dhe mbi këtë truall është ndërtuar një banesë me sip.130 m², në vlerën 2.000.000 lekë. Burimi i krijimit: me shumën e mbetur *cash* dhe të ardhurat nga paga e bashkëshortes të ushtruar në biznesin familjar në vitet 1996 – 2001.

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.2 Për këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin në vlerën 2.000.000 lekë dhe me mungesën e burimit financiar, i cili ka shërbyer për ndërtimin e objektit karabina.

2.3 Subjekti ka deklaruar se në datën 1.9.1998 ka blerë nga shtetasi G.S.S një sipërfaqe trualli prej 500 m², për shumën 400.000 lekë me kontratë paraprake me avokat dhe e formalizuar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 9.5.2001, pas marrjes së vërtetimit të pronësisë. Vlera: 400.000 lekë. Pjesa takuese e pasurisë është deklaruar 100%.

2.4 Subjekti ka deklaruar se mbi këtë truall është ndërtuar një banesë në fazën e karabinasë me sip. 130 m², e filluar me shumën e mbetur *cash* dhe nga të ardhurat nga paga e bashkëshortes, të ushtruar në biznesin familjar në vitet 1996 – 2001. Shpenzime ndërtimi gjithsej 2.000.000 lekë.

Analiza e fakteve

2.5 Rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. *** prot., datë 1.9.1998, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi G.S një sipërfaqe toke prej 500 m², kundrejt çmimit 400.000 lekë. Sipas kësaj kontrate, në prani të avokatit, vlera është likuiduar me nënshkrimin e kontratës, si dhe do të dorëzohet trualli menjëherë për ndërtim banese.

2.6 Për këtë pasuri është lidhur më pas edhe një kontratë shitblerjeje me nr. 2499/620, datë 9.5.2001, përpara noterit me palë shitëse G dhe R.S dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit. Pasuria tokë është regjistruar me nr. ***, me vendndodhje në Kavajë, lloji i pasurisë arë me sip. 500 m², në z. k. nr. ***, regjistruar në ZRPP-në Kavajë. Shuma e përcaktuar në këtë kontratë shitjeje është në vlerën 500.000 lekë, shumë e cila është deklaruar e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Kjo vlerë e blerjes sipas kontratës nuk përkon me deklarinimin e bërë nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

2.7 Pra, për këtë pasuri tokë rezultuan dy kontrata shitblerjeje me vlera të ndryshme, njëra 400.000 lekë dhe tjetra 500.000 lekë.

2.8 ZVRPP-ja Kavajë ka konfirmuar se në pronësi të subjektit të rivlerësimit ka qenë e regjistruar pasuria tokë “arë” nr. ***, me sip. 500 m². Këtë pasuri subjekti e ka shitur me anë të kontratës nr.***, datë 19.3.2004.

2.9 DPPPP-ja ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit në datën 19.3.2004 i ka shitur një tokë arë me çmim të deklaruar 500.000 lekë palës blerëse H.Nj.L dhe G.H.L.

2.10 Nga të dhënat e dërguara nga institucionet financiare shtetërore² nuk rezultoi që subjekti apo personat e lidhur të kenë ushtruar aktivitet tregtar dhe për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore (sipas subjektit një pjesë e të ardhurave për ndërtimin e objektit janë nga të ardhurat e pagës së bashkëshortes në biznes).

²Shihni përgjigjet e drejtorisë së tatimeve dhe sigurimeve shoqërore.

- 2.11** Subjekti ka deklaruar se dhe me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.3.2004, i është shitur objekt karabina e ndërtuar në Kavajë me sip. 130 m², shtetasit H.L. Vlera e shitjes së pasurisë është deklaruar nga subjekti në shumën prej 2.500.000 lekësh.
- 2.12** Rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.3.2004, subjekti i rivlerësimit i ka shitur shtetasve H dhe G.L pasurinë “arë” me sip. 500 m², me nr. ***, në z. k. nr. ***, me vendndodhje në Kavajë, regjistruar në ZRPP-në Kavajë dhe jo pasurinë objekt karabina me sip. 130 m².
- 2.13** Për shitjen e pasurisë karabina rezultoi një aneks kontratë me shkresë të thjeshtë të datës 19.3.2004, ku deklarohet se subjekti i rivlerësimit është pronar i vetëm i pasurisë me nr. ***, me vendndodhje pasurie në Kavajë, e llojit “arë”, me sip. 500 m², në të cilën ka ndërtuar një shtëpi banimi, e cila nuk figuron e regjistruar në ZRPP-Kavajë dhe se këtë pasuri ia shet shtetasit H.L. Për këtë aneks kontratë me nr. *** është lëshuar një vërtetim nënshkrimi para noterit datë 19.3.2004.
- 2.14** Në datën 19.3.2004 palët kanë nënshkruar një kontratë shitblerjeje me nr. ***, në të cilën është përshkruar vetëm sipërfaqja e tokës dhe çmimi i shitjes së saj pa përfshirë në të çmimin e shitblerjes së shtëpisë.
- 2.15** Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.3.2004, të lidhur përpara noterit, është shitur vetëm pasuria tokë dhe jo pasuria objekt në fazën e karabinasë.
- 2.16** Lidhur me çmimin e shitblerjes së shtëpisë së banimit palët deklarojnë se është në shumën 2.500.000 lekë, e cila është dhënë nga blerësi dhe është marrë nga subjekti i rivlerësimit, pa pasur asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit. Gjithashtu përcaktohet dhe se blerësi H.L merr përsipër të përfundojë vetë procedurat e regjistrimit të shtëpisë.
- 2.17** Për shumën e pretenduar të përfituar prej 2.500.000 lekësh, si rezultat i shitjes së objektit pa leje nuk rezultoi që të jenë paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit (tatim mbi të ardhurat).
- 2.18** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se punimet e ndërtimit janë kryer në vitin 1998. Bazuar në koston e Entit Kombëtar të Banesave për vitin 1998, vlera e ndërtimit të pasurisë me sip. prej 130 m² llogaritet 3.624.140 lekë (130 x 27.878 = 3.624.140, bazuar në Udhëzimin nr. 214, datë 28.4.1999, të KM-së).
- 2.19** Subjekti është pyetur në mënyrë që të provojë periudhën e ndërtimit të objektit karabina dhe të paraqesë dokumentacion provues lidhur me pagesat e kryera për këtë pasuri.
- 2.20** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka deklaruar se: *“Të ardhurat familjare të bashkëshortes janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e ndërtimit dhe koston punëtore; pagesat kryheshin cash në dorë, si dhe nuk disponoj dokumentacion shkresor për të provuar shpenzimet e kryera”*.

Analiza financiare

Analiza financiare	Para vitit 2003
PASURI	10,167,168
Apartament 1+1, L. Nr. ***, Kavajë - Sali Hasa - 1993 - 100%	13,268
Truall me sip. 500 m ² , Kavajë - 1998 - Sali Hasa - 100%	500,000
Banesë karabina me sip. 130 m ² , Kavajë	3,624,140
Apartament me sip. 163.28 m ² , Durrës -50,000 USD - Sali Hasa - 100%	6,029,760

DETYRIME	0

PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	10,167,168
--	-------------------

Të ardhura të dokumentuara	2,209,453
Të ardhura nga shitja apartament Kavajë blerë në vitin 1993 - 1.500.000 lekë	1,500,000
Të ardhura nga puna subjekti Sali Hasa	2,010,385
Të ardhura nga puna bashkëshortja M.H	258,909
SHPENZIME	1,066,881
Shpenzime jetese	918,746
Shpenzime për sigurime vullnetare M.H	148,135

Analiza e dokumentuar	-9,024,596
------------------------------	-------------------

Në përfundim të hetimit, Komisioni, pasi hartoi analizën financiare për pasuritë e krijuara nga subjekti para vitit 2003, duke përfshirë edhe pasurinë truall me sip. 500 m² dhe banesën karabina me sip. 130 m², e deklaruar si e ndërtuar mbi truall, konstatoi se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e këtyre pasurive.

2.21 Komisioni për këtë pasuri ka konstatuar se:

- i. Ka mungesë të dokumentacionit ligjor për ndërtimin e objektit (mungesë leje ndërtimi dhe akte të tjera që vërtetojnë ndërtimin e objektit).
- ii. Ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit karabina me sip. 130 m², në Kavajë, në shumën e deklaruar nga subjekti prej 2.000.000 lekësh.
- iii. Në analizën financiare, ndërtimi në fjalë është vlerësuar nga Komisioni bazuar në koston e ndërtimit, sipas Udhëzimit nr. ***, datë 28.4.1999, të KM-së në vlerën prej 3.624.140 lekësh.
- iv. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar, i cili ka shërbyer për ndërtimin e karabinasë në shumën e pretenduar nga subjekti prej 2.000.000 lekësh ose 3.624.140 lekë (vlera e llogaritur sipas koston së ndërtimit).
- v. Nuk konfirmohet punësimi i bashkëshortes së subjektit në aktivitetin tregtar në emër të personave të lidhur me të (babai), për të cilin është deklaruar burimi i të ardhurave për ndërtimin e kësaj pasurie.
- vi. Mospërputhje të vlerës në deklaratën *Vetting* lidhur me blerjen e pasurisë tokë të deklaruar 400.000 lekë, pasi në kontratën e shitblerjes rezulton vlera 500.000 lekë.
- vii. Mospërfshirja e ndërtesës me sip. 130 m² dhe vlerës së saj në kontratën e shitblerjes me nr. ***, datë 19.3.2004. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me

përdorimin e kontratës së datës 19.3.2004 si kontratë për shitjen e pasurisë karabina. Hartimi i aneks kontratës është më shkresë të thjeshtë dhe jo përpara noterit.

- viii. Mospërputhja në deklarata pasi subjekti ka deklaruar se kontratën e shitjes së pasurisë objekt karabina e ka lidhur përpara noterit, por gjatë hetimit nuk rezultoi të jetë lidhur kontratë para noterit për shitjen e pasurisë ndërtesë.
- ix. Mungesë dokumentacioni ligjor për mënyrën dhe periudhën e përfitimit të shumës së pretenduar prej 2.500.000 lekësh.
- x. Subjekti nuk ka lidhur kontratë para noterit lidhur me shitjen e pasurisë ndërtesë me sip. 130 m² dhe nuk rezultoi të jenë paguar detyrimet përkatëse, tatimi mbi të ardhurat në shumën e pretenduar prej 2.500.000 lekësh.
- xi. Komisioni, në analizën financiare, nuk mori parasysh të ardhurat e shitjes së ndërtesës karabina me sip. 130 m², të deklaruar nga subjekti në vitin 2004, pasi nuk është vërtetuar kjo gjë nga subjekti dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj.
- xii. Bazuar në analizën financiare në pikën 2.20, subjekti ka pasur mungesë burimesh financiare për krijimin e pasurisë truall me sip. 500 m² + ndërtesë 130 m².

2.22 Për të gjitha gjetjet e mësipërme Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.23 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar³ se: *“Tokën me sip. 500 m² e kam blerë nga shtetasi G.S.S me kontratë noteriale në shumën prej 500.000 lekësh. Burim për blerjen e saj ka qenë shuma e përfituar nga shitja e apartamentit në Kavajë”.*

Subjekti, në prapësime, sqaron se mbi tokën truall ka ndërtuar pa leje një ndërtesë njëkatëshe me sip. 130 m². Punimet e ndërtimit janë kryer nga subjekti dhe të afërmit dhe vlera është llogaritur 2.000.000 lekë. Ndërtesa nuk është përfunduar dhe është shitur karabina në vlerën 2.500.000 lekë. Nuk është bërë kontratë noteriale për shkak se ka qenë pasuri e ndërtuar pa leje dhe e pa regjistruar.

Subjekti ka deklaruar se nuk është dakord me mosmarrjen në konsideratë të shumës 2.000.000 lekë që ka shpenzuar për ndërtimin e banesës me sip. 130 m² dhe llogaritjen nga Komisioni të vlerës së ndërtimit në shumën prej 3.624.140 lekë për faktin se ndërtimin e saj e ka bërë vetë dhe jo me shoqëri ndërtimi.

Vlerësimi i Komisionit

2.24 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti prova dhe argumente për të kundërshtuar konstatimet e bëra nga Komisioni.

2.25 Subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues lidhur me ndërtimin e kryer dhe vlerën e shpenzuar në total. Pavarësisht ndërtimit të pretenduar të bërë prej tij dhe të afërmit e tij nuk paraqiti argumente bindëse pse nuk mund t'i referohet kostos së ndërtimit të miratuar me akt normativ të Këshillit të Ministrave. Edhe nëse Komisioni do të merrte

³Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit në dosjen e Komisionit.

në konsideratë koston e ndërtimit në vlerën 2.000.000 lekë sipas deklaramit të subjektit dhe vlerën e trullit prej 500.000 lekësh, përsëri subjekti do të rezultonte në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

- 2.26** Subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit lidhur me ligjshmërinë e shumës së deklaruar prej 2.000.000 lekësh për ndërtimin e kryer me burim nga të ardhurat e bashkëshortes. Bazuar në përgjigjet e institucioneve përkatëse⁴ nuk rezultoi se bashkëshortja e subjektit të këtë qenë e punësuar dhe të këtë përfituar të ardhura për të cilat të jenë paguar edhe detyrimet përkatëse.
- 2.27** Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar përfitim të ardhurash në shumën 2.500.000 lekë nga shitja e kësaj pasurie, por nuk rezultoi pagimi i detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit mbi këto të ardhura.
- 2.28** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit ka qenë i pasaktë në deklaramet e bëra për këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit nuk justifikon shpenzimet e kryera për ndërtimin e karabinasë me sip. 130 m², në Kavajë, si dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e ligjshëm financiar në shumën e deklaruar prej 2.000.000 lekësh, shumë e cila është deklaruar se ka shërbyer për ndërtimin e këtij objekti. Subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Apartament me sip. 163 m², në Durrës

- 3.1** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.5.2005, është blerë banesa e porositur sipas kontratës së porosisë të vitit 2001 me M.Ç e A.M, për një vlerë prej 1.700.000 lekësh, redaktuar nga noter M.K në Durrës. Burimi i kësaj shume është prishja e depozitës së kursimit në emër të bashkëshortes me Bankën e Kursimit Durrës. Mbeten gjendje cash 800.000 lekë. Ky apartament është bërë i banueshëm në vitin 2012 me gjendjen dhe me kursimet familjare për 7 vjet*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 3.2** Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar mosdeklarim burimi financiar, mungesë burimi të ligjshëm, mosdeklarim të pasurisë në deklaratën e fillimit të detyrës në vitin 2004 dhe mosdeklarim të detyrimit të mbetur ndaj palës shitëse.
- 3.3** Për këtë pasuri rezultoi se është lidhur një kontratë sipërmarrjeje me nr. ***, datë 20.4.2001, për ndërtimin e një apartamenti 3 +1, me sip. 163.3 m², me palë sipërmarrëse shoqëria “****” dhe palë porositëse subjektin e rivlerësimit. Vlera e kontratës së sipërmarrjes është në shumën 50.000 USD.
- 3.4** Sipas kontratës së sipërmarrjes është përcaktuar se vlera do të paguhet:
- a) kësti i parë në vlerën 6.500 USD + 6.500 USD, paguar në datat 1.2.2001 dhe 15.2.2001;
 - b) kësti i dytë në shumën 6.500 USD + 6.500 USD është likuiduar në datën 28.2.2001 dhe 15.3.2001;

⁴Shihni përgjigjet e DRT-së dhe DSSH-së në dosjen e Komisionit.

- c) kësti i tretë në shumën 6.000 USD do të likuidohet në datën 15.4.2001, 6.000 USD në datën 15.5.2001 dhe 6.000 USD në datën 15.6.2001;
 - d) kësti i fundit do të likuidohet me dorëzimin e apartamentit në shumën 6.000 USD.
- 3.5** Deri në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes (datë 20.4.2001) është paguar shuma prej 32.000 USD. Brenda vitit 2001 duhej të paguhej dhe shuma prej 12.000 USD dhe kësti i fundit prej 6.000 USD do të paguhej me marrjen në dorëzim të apartamentit.
- 3.6** Nuk rezultoi ndonjë revokim i kontratës së sipërmarrjes së vitit 2001 nga ana e palëve, gjë që konfirmon faktin se kjo kontratë është zbatuar me përpikmëri nga palët.

Analiza e fakteve

- 3.7** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në vitin 2001 është lidhur një kontratë sipërmarrjeje e formalizuar mbi marrëveshjen verbale të bërë në vitin 1999, me ndërtuesit A.M dhe M.C, për ndërtimin e një apartamenti me sip. 163 m², në Durrës. Vlera e deklaruar për blerjen e kësaj pasurie është në shumën 50.000 USD. Pjesa takuese e subjektit: 100%. Deklarimi i subjektit nuk duket i saktë lidhur me marrëveshjen e bërë në vitin 1999 me ndërtuesin A.M. dhe M.Ç., pasi bazuar në kontratën e sipërmarrjes leja e sheshit dhe leja e ndërtimit të objektit është marrë në vitin 2000.
- 3.8** Në DPV-në e vitit 2004 subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri apartament, kontratën e sipërmarrjes apo likuidimet dhe detyrimet ndaj palës A. M. dhe M. Ç. Subjekti ka filluar detyrën si prokuror në datën 16.7.2004 dhe deklaratën fillestare të pasurisë e ka plotësuar në datën 17.3.2005 (pra, disa muaj më vonë se afati ligjor për deklarimin brenda 1 muaji nga momenti i fillimit të detyrës).
- 3.9** Në DPV-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“Shtëpi banimi me sip. 153 m², e përfunduar nga shoqëria ‘***’, Durrës. Nuk ka ndryshime të tjera, por gjendja është si në deklarin e vitit 2004”*.
- 3.10** Në DPV-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar: *“Shtëpi banimi me sip. 153 m², e përfunduar nga shoqëria ‘***’, Durrës. L. Nr.***, rruga ‘***’, ap. ***, me kontratë sipërmarrjeje që nga viti 1999. Shlyer me këste deri në momentin e regjistrimit në ZVRPP Durrës 500.000 lekë në vit – 50.000 USD - 100%”*. Sipas këtij deklarimi të vitit 2006 duket se për këtë pasuri është paguar deri në vitin 2006 shuma prej 4.000.000 lekësh dhe pjesa e mbetur është paguar menjëherë në vitin 2006.
- 3.11** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se: *“Bisedimet me palën shitëse kanë filluar që në vitin 1999; kontrata e lidhur me palën shitëse nuk është respektuar asnjëherë për shkak se firma nuk kishte kryer punimet me korrektësi dhe në afat; në vitin 2005 është konkluduar që të hartohet kontrata e shitjes së apartamentit karabina e papërfunduar në vlerën 1.700.000 lekë; këstet e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes nuk janë zbatuar ndonjëherë, por dhe një sasi lekësh që ishte dhënë si garanci në fillim me lidhjen e kontratës, shoqëria i ka kthyer në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 2005; burimi financiar për vlerën 1.700.000 lekë vjen nga pakësimi i depozitës së tërhequr në vlerën 2.500.000 në vitin 2004. Pjesa e mbetur prej 800.000 lekësh është mbajtur cash”*.

- 3.12** Kontrata për shitblerjen e kësaj pasurie është lidhur më datë 27.5.2005. Pala shitëse deklaron se ka në pronësi apartament me sip.163.28 m² e regjistruar pranë Zvrpp Durrës. Vlera e Kontratës është deklaruar 1.700,000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Sipas kësaj kontrate apartamenti është i lirë nga çdo barrë ose pengesë ligjore dhe palët nuk kanë asnjë pretendim ndaj tyre.
- 3.13** Rezulton se subjekti ka bërë deklarime kontradiktore në të gjitha deklaratat (si në DPV përkatëse si deklaratën *Vetting* si në përgjigje të pyetësorit) lidhur me këtë pasuri, mënyrën e përfitimit, vitin, vlerën dhe pagesat e kryera etj.
- 3.14** Komisioni konstatoi se nëse subjekti ka lidhur kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie në vitin 2005 dhe ka paguar vlerën prej 1.700.000 lekësh, nuk kishte pse të deklaronte të kundërtën në DPV-në e vitit 2006, në të cilën ka deklaruar: *“Pakësuar depozita nga ‘Raiffeisen Bank’ për shumën gjendje depozite për pagimin e këstit të fundit – 2.500.000 lekë”*. Pra, subjekti ka konfirmuar pagesat e kryera deri në vitin 2006 për këtë pasuri bazuar në kontratën me vlerë 50.000 USD dhe këstin e fundit e ka paguar në vitin 2006 në vlerën 2.500.000 lekë.
- 3.15** Burimi i pretenduar nga depozita e krijuar në vlerën 2.500.000 lekë nuk u mor në konsideratë nga Komisioni si burim për blerjen e kësaj pasurie. Kjo shumë nuk është provuar nga subjekti si burim i ligjshëm.
- 3.16** Duke iu referuar analizës financiare të hartuar nga Komisioni për periudhën para vitit 2003⁵, dukej se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për kryerjen e pagesave sipas kontratës së sipërmarrjes së vitit 2001.
- 3.17** Vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes prej 1.700.000 lekësh nuk është në përputhje me deklaratimet dhe kontratën e sipërmarrjes, si dhe është një vlerë e ulët në raport me çmimet e tregut, gjë që ngriti dyshimin për veprime fiktive në kontratën e shitjes, duke sjellë për pasojë deklaram me vlerë të ulët dhe jo vlerën reale dhe shmangie të detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit.
- 3.18** Duke llogaritur vlerat e ndërtimit në tregun e lirë për vitin 2005 (VKM-ja për miratimin e çmimeve të apartamenteve/sip. shfrytëzimi nr. ***, datë 23.11.2005) në qytetin e Durrësit, çmimi për këtë apartament me sip. 163.3 m² llogaritet në vlerën 8.955.045 lekë (163.3 m² x 54.838 lekë/m² = 8.955.045 lekë). Ndërkohë bazuar në të njëjtin VKM, vlera e koston së ndërtimit është 4.306.710 lekë (163.3 m² x 26.373 lekë/m² = 4.306.710 lekë).
- 3.19 Komisioni për këtë pasuri ka konstatuar se:**
- i. Subjekti ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *Vetting* në vlerën 1.700.000 lekë dhe si burim krijimi ka deklaruar depozitën bankare me vlerë 2.500.000 te ish-banka e kursimeve. Kjo depozitë nuk është krijuar me burime të ligjshme dhe nga Komisioni nuk është marrë në konsideratë kjo e ardhur si burim për pasurinë apartament me sip. 163.3 m², në Durrës.
 - ii. Subjekti nuk ka deklaruar këtë pasuri apartament me sip. 163 m², blerë në vitin 2001, në Durrës, me vlerë 50.000 USD, në deklaratën për herë të parë në vitin 2004.

⁵Shihni analizën financiare në pikën 2.22 të këtij vendimi.

- iii. Deklaratën e pasurisë për herë të parë subjekti e ka dorëzuar disa muaj pas fillimit të detyrës në shkelje të afatit ligjor prej 30 ditëve (detyrim i caktuar nga ligji nr. 9049, viti 2003).
- iv. Në deklaratën për herë të parë në vitin 2004, por edhe në DPV-në e vitit 2005 subjekti nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë sipërmarrëse. Për më tepër, subjekti, në DPV-në e vitit 2005 ka deklaruar: *“Nuk kam asnjë detyrim financiar ndaj personave juridikë ose fizikë brenda dhe jashtë vendit”*.
- v. Në DPV-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar: *“Pakësuar depozita nga ‘Raiffeisen Bank’ për shumën gjendje depozite për pagimin e këstit të fundit – 2.500.000 lekë”*. Me këtë deklaratë subjekti ka konfirmuar pagesat e kryera deri në vitin 2006 për këtë pasuri, bazuar në kontratën me vlerë 50.000 USD, si dhe këstin e fundit e ka paguar në vitin 2006 nga vlera e pretenduar e depozitës prej 2.500.000 lekësh.
- vi. Subjekti duket se ka bërë disa deklarime kontradiktore lidhur me vlerën e pasurisë, likuidimet dhe afatet e kryerjes së tyre.
- vii. Nuk përcaktohet dhe provohet sa është vlera e kësaj pasurie dhe sa janë vlerat e paguara, ndër vite, për këtë pasuri nga subjekti.
- viii. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri dhe është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë faktet dhe vlerat financiare për këtë pasuri në pronësi të tij.
- ix. Nuk përkon asnjë nga deklaramet e subjektit me deklaramat e bëra prej tij dhe me dokumentacionin shkresor provues lidhur me këtë pasuri dhe vlerat përkatëse.
- x. Deklarata *Vetting* duket se bie në kundërshtim me deklaramat periodike vjetore të bëra nga subjekti.
- xi. Vlera e deklaruar e blerjes në deklaramtën *Vetting* (1.700.000 lekë) është nën mesataren e kostos së ndërtimit në zonën përkatëse (kostoja e ndërtimit 4.306.710 lekë) dhe është gjithashtu nën çmimin e tregut në këtë zonë (vlera e tregut 8.955.045 lekë).
- xii. Dyshime lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 163.28 m², në Durrës, në shumën 1.700.000 lekë, në vitin 2005, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes e vitit 2001 parashikon çmimin total prej 50.000 USD. Dyshohet që vlera në kontratën e shitblerjes të jetë bërë me qëllim mosdeklarimin e saktë të vlerës dhe shmangien e detyrimeve tatimore në favor të organeve kompetente.
- xiii. Në analizën financiare vlera e pasurisë është ndarë në dy pjesë: pjesa e parë në vlerën 44.000 USD përfshihet në periudhën para vitit 2003; dhe pjesa tjetër prej 6.000 USD është përfshirë në vitin 2005, në të cilin është bërë kontrata e shitblerjes. Vlerat dhe llogaritja është bërë duke u bazuar në kontratën e sipërmarrjes.
- xiv. Burimi i krijimit të kësaj pasurie, nga tërheqja e depozitës bankare, trajtohet në pikën 4 të rezultateve të hetimit. Theksohet se vlera e kësaj depozite prej 2.500.000 lekësh (edhe nëse do të konsiderohej si burim i ligjshëm) nuk është e mjaftueshme për mbulimin e të gjithë vlerës së apartamentit prej 50.000 USD.
- xv. Nuk provohet deklarimi i subjektit se kontrata e lidhur me palën shitëse nuk është respektuar asnjëherë për shkak se shoqëria nuk kishte kryer punimet me korrektësi

dhe në afat. Kjo nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti, nuk provohet me dokumente shkresore dhe nuk provohet as nga deklaratat periodike vjetore të paraqitura pranë ILDKPKI-së.

- xvi. Nuk është provuar që në vitin 2005 është konkluduar për hartimin e kontratës së shitjes së apartamentit, karabina e papërfunduar, në vlerën 1.700.000 lekë. Duket se godina/apartamenti është e regjistruar çka do të thotë se është ndërtuar plotësisht. Nuk provohet me kontratë shitjeje se apartamenti ka pasur të metë apo se nuk mund të jetë objekt karabina vetëm i ndërtuar me kolona. Nuk provohet ndërtimi më pas nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerat e shpenzuara për këtë ndërtim, pasi nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti në DPV-të përkatëse.
 - xvii. Nuk provohet që këstet e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes nuk janë zbatuar ndonjëherë, por edhe një sasi lekësh që ishin dhënë si garanci në fillim me lidhjen e kontratës shoqëria t'ia ketë kthyer subjektit në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 2005. Nga ana e subjektit nuk është deklaruar asnjëherë ky pretendim. Duket se nuk përbën sens që shoqëria t'i kthente lekët kur subjekti i detyrohej shoqërisë shumë prej 1.700.000 lekësh. Kthimi i shumës nga shoqëria dhe vlera e saj nuk është deklaruar asnjëherë në DPV-të përkatëse.
 - xviii. Nuk provohet burimi financiar për vlerën 1.700.000 lekë, i deklaruar se vjen nga pakësimi i depozitës së tërhequr në vlerën 2.500.000, në vitin 2004. Depozita në vlerën 2.500.000 duket se është krijuar me burim të paligjshëm (trajtuar në pikat 2 dhe 4 të rezultateve të hetimit). Nuk provohet që pjesa e mbetur prej 800.000 lekësh është mbajtur *cash*, pasi nuk është deklaruar kjo gjë nga subjekti në deklaratat periodike vjetore.
- 3.20** Për të gjitha gjetjet e mësipërme Komisioni i kaloi barrë prove subjektit në bazë nenit 52 të ligjit 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- 3.21** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁶ se banesën në qytetin e Durrësit e ka blerë në shumë 1.700.000 lekë me akt noterial për shkak se shoqëria e ndërtimit nuk e respektoi kontratën e porosisë. Shuma prej 1.700.000 lekësh është paguar nga shuma 2.500.000 lekë, që subjekti ka deklaruar se ka përfituar nga shitja e banesës në qytetin e Kavajës.

Më tej, subjekti deklaroi se rasti i tij është si shumë raste në Shqipëri, ku shoqëritë e ndërtimit nuk i qëndrojnë kontratës së porosisë, ku dhe sot nuk ka mundur ta shesë banesën për shkak të cilësisë së dobët të punimeve.

Vlerësimi i Komisionit

- 3.22** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti prova dhe argumente bindëse për të kundërshtuar asnjë nga konstatimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri.

⁶Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit në dosjen e Komisionit.

- 3.23** Subjekti nuk paraqiti asnjë argument lidhur me deklaratat kontradiktore të bëra prej tij në DPV-të ndër vite, në raport me deklaratën *Vetting* dhe me përgjigjet e pyetësorit për blerjen e pasurisë apartament.
- 3.24** Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë apo shpjegim lidhur me të gjitha konstatimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri, sipas pikës 3.19 më sipër në këtë vendim.
- 3.25** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram kontradiktor, të pasaktë dhe të rremë lidhur me vlerën dhe burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germave “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Depozitë bankare në Bankën e Kursimeve

- 4.1** Subjekti ka deklaruar (në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën fillestare të vitit 2004) të ardhurat nga shitja e banesës në vlerën 2.500.000 lekë. Sipas subjektit kjo vlerë është depozituar në Degën e Bankës së Kursimeve Durrës në datën 2.4.2004, në emër të bashkëshortes M.H. Pjesa takuese e subjektit është 100%.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 4.2** Bazuar në vërtetimin e Bankës së Kursimeve rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka depozituar shumën 2.500.000 lekë, në datën 2.4.2004.
- 4.3** Sipas deklaramit të subjektit kjo shumë është përfituar nga shitja e pasurisë “shtëpi banimi” në qytetin e Kavajës (trajtuar më sipër në këtë vendim). Në bazë të analizës së bërë për këtë pasuri nuk është vërtetuar fakti i krijimit të saj, i shitjes më pas dhe krijimit të të ardhurave të përfituara, për të cilat janë paguar edhe detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit⁷.
- 4.4** Kjo depozitë bankare është tërhequr më 4.4.2005, në vlerën 2.651.258 lekë. Subjekti nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005 përdorimin e shumës si shpenzim apo ruajtjen si gjendje *cash* në fund të vitit 2005.
- 4.5** Pakësimin e depozitës bankare prej 2.500.000 lekë, subjekti e deklaroi vetëm në DPV e vitit 2006 me qëllim pagimin e këstit të fundit për blerjen e apartamentit të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi.

4.6 Komisioni për këtë pasuri ka konstatuar se:

- i. Burimi i krijimit të kësaj shume prej 2.500.000 lekësh, mbetet i paprovuar nga subjekti i rivlerësimit (trajtuar më sipër në pikën 2 të vendimit). Si rrjedhim, në analizën financiare, Komisioni nuk mori në konsideratë si të ardhura të ligjshme edhe interesat e përfituara nga kjo depozitë.
 - ii. Nuk u provua nga subjekti përdorimi i depozitës si burim për krijimin e pasurisë apartament dhe vlera e përdorur nga kjo depozitë.
- 4.7** Për gjetjet e mësipërme Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁷Shihni trajtimin e bërë për pasurinë në pikën 2 të këtij vendimi.

4.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi⁸ se nuk është dakord për moskonsiderimin e të ardhurave nga Komisioni për këtë depozitë bankare.

Subjekti në prapësime sqaron se të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja janë me burim të ligjshëm me një pagë prej 25,000 lekë në muaj në biznesin familjar.

Vlerësim i Komisionit

4.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk paraqiti prova për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me krijimin e depozitës prej 2.500.000 lekësh dhe përdorimin e saj për shlyerjen e këstit të fundit të blerjes së apartamentit me sip. 163 m², në Kavajë⁹.

4.10 Subjekti nuk arriti të paraqesë prova për të ardhurat e bashkëshortes nga biznesi familjar (burimi fillestar i krijimit të depozitës bankare në vlerën 2.500.000 lekë) dhe për të cilat janë paguar detyrimet financiare në buxhetin e shtetit.

4.11 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Apartament me sip. 90 m², në Sarandë

5.1 Subjekti ka deklaruar se me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 21.12.2010, lidhur midis bashkëshortes së tij dhe sipërmarrësit D.M në qytetin e Sarandës, është porositur apartamenti me sip. 90 m², me vlerë 3.960.000 lekë, e cila do të paguhej me këste. Me kontratën e kredisë bankare me nr.***, datë 18.3.2011, në BKT, me kredimarrës M dhe L.H dhe dorëzanës Sali dhe A.H, ka kaluar shuma prej 3.168.000 lekësh nga banka te sipërmarrësi, ndërsa pjesa tjetër prej 720.000 lekësh është paguar pas prishjes së depozitës në shumën 800.000 me BKT-në nga bashkëshortja M.H në vitin 2014. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi i kryer nga Komisioni

5.2 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar mosdeklarim të kontratës së sipërmarrjes në DPV-në e vitit 2010, mosdeklarim dhe deklaram të rremë lidhur më këstin e parë të paguar në vitin 2014, në shumën 792.000 lekë, çmim preferencial për blerjen e pasurisë apartament me sip. 90 m², në shumën 3.960.000 lekë, në vitin 2010, në Sarandë.

5.3 Rezultoi se me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 21.12.2010, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka porositur te pala sipërmarrëse D.M një apartament 2+1, me sip. 90 m², kundrejt pagesës 3.960.000 lekë.

5.4 Sipas kontratës së sipërmarrjes, kësti i parë në shumën 792.000 lekë është paguar para nënshkrimit të saj dhe kësti i dytë në shumën 3.168.000 lekë do të likuidohej nga porositësja me marrjen prej saj të kredisë bankare në BKT.

⁸Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit në dosjen e Komisionit.

⁹Referojuni gjetjeve lidhur me pasurinë e përmendur në pikën 2 të vendimit.

- 5.5** BKT-ja ka konfirmuar kredi në emër të shtetasës M.H me gjendje në datën 27.1.2017, në shumën 2.4322.246 lekë. Kjo kredi i ka kaluar më pas palës sipërmarrëse më anë të transfertës bankare.
- 5.6** Kredia e përfituar ka qenë në kushtet e kredisë lehtësuese bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”.
- 5.7** Rezultoi e paqartë mënyra e përfitimit të kësaj kredie nga bashkëshortja e subjektit dhe djali, pasi duket se nuk përfshihen në kategorinë e personave përfitues sipas VKM-së më sipër, kjo edhe për faktin se dispononin pasuri tjetër të paluajtshme. Për sigurimin e kredisë bankare është hipotekuar pasuria nr. ***, apartament me sip. 72 m², e regjistruar në emër të shtetasit V.M.
- 5.8** Rezultoi se në DPV-në e vitit 2010, dorëzuar në ILDKPKI, subjekti nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes së lidhur për këtë pasuri. Gjithashtu, në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar as pagesën e kryer për këstin e parë prej 792.000 lekësh ndaj palës sipërmarrëse.

Analiza e fakteve

- 5.9** Në DPV-në e vitit 2014 subjekti nuk ka deklaruar përsëri këtë pasuri, pagesën e pretenduar të kryer prej 792.000 lekësh dhe as mbylljen e depozitës me vlerë 800.000 lekësh në BKT.
- 5.10** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka vënë në dispozicion mandatarkëtimin e datës 6.5.2014, për pagimin e vlerës 792.000 lekë shoqërisë sipërmarrëse.
- 5.11** Referuar shkresës nr. ***, datë 6.4.2018, të Drejtorisë së Tatimeve rezultoi se mandatarkëtimi nuk është dokument i njohur nga legjislacioni tatimor, gjë që duket se nuk vërteton pretendimet e subjektit.
- 5.12** Bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 3.2.2010, të Këshillit të Ministrave, dukej se çmimi në tregun e lirë për këtë pasuri është në vlerën 4.455.000 lekë (90 m² x 49,500 lekë/m² = 4.455.000 lekë).

5.13 Komisioni për këtë pasuri konstatoi se:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 21.12.2010, në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2010 dhe as në deklaratat periodike në vijim.
- ii. Subjekti nuk ka deklaruar pagesën e këstit prej 792.000 lekësh si detyrim ndaj shoqërisë për apartamentin me sip. 90 m², në Sarandë, as në DPV-të e viteve 2010 dhe 2014.
- iii. Subjekti nuk ka deklaruar mbylljen e depozitës bankare në vitin 2014, në shumën 800.000 në DPV e atij viti dhe as ka deklaruar shlyerjen nga kjo depozitë të shumës 792.000 lekë ndaj palës sipërmarrëse.
- iv. Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur më këstin e parë të paguar në vitin 2014 në shumën 792.000 lekë, për blerjen e apartamentit në Sarandë, pasi në

kontratën e sipërmarrjes datë 21.12.2010, citohet se kjo shumë është shlyer para nënshkrimit të kontratës, ndërsa sipas deklarimit të subjektit në deklaratën *Vetting*, kjo shumë është paguar në vitin 2014 nga tërheqja e depozitës në BKT.

- v. Rezultoi se subjekti ka pasur çmim preferencial për blerjen e pasurisë apartament me sip. 90 m², në shumën 3.960.000 lekë, porositur në vitin 2010, në Sarandë.
- vi. Rezultoi i paqartë përfitimi i kredisë së butë dhe respektimi i dispozitave (kushteve dhe kritereve) ligjore për përfitimin e saj.
- vii. Në analizën financiare vlera e pasurisë është e përfshirë e gjitha në vitin 2010, sipas kontratës së sipërmarrjes. Në vitin 2014 nuk është përfshirë ndonjë likuidim lidhur me këtë pasuri, meqë nuk ishte deklaruar një gjë e tillë në DPV-në e vitit 2014.
- viii. Kontrata e sipërmarrjes është e datës 21.12.2010. Nga analiza financiare e vitit 2010 (pika 15), shihet se subjekti dhe familjarët kanë pasur burime të mjaftueshme për shtimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin.

5.14 Për të gjitha gjetjet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.15 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve, deklaroi vetëm se çdo gjë është e dokumentuar me dokumente zyrtare, të cilat provojnë se ka pasur mundësi financiare për të hyrë në transaksione dhe për të marrë kredi. Dyshimi se çmimi i blerjes ka qenë më i ulët nuk bazohet në ndonjë element apo *indicie* për favorizim, përkundrazi injoron ligjin e kërkesës dhe ofertës, sidomos kushtet e urgjencës që kishte pala shitëse dhe nevojat e saj për para në momentin e transaksionit.

5.16 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente dhe prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit të bëra në mënyrë të detajuar në pikën 5.13 të vendimit.

5.17 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, kontradiktor dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të gremës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Tokë kullotë në *, Himarë**

6.1 Subjekti ka deklaruar se me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 17.10.2014, shtetasi V.R u ka dhuruar një sipërfaqe toke (kullotë) prej 1.000 m² në ***, Himarë, dy fëmijëve të subjektit L dhe A.H. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-Vlorë, më 5.2.2015. Në këtë sipërfaqe toke është deklaruar se nuk është bërë asnjë investim. Pjesa takuese: 50%+50%.

Hetimi i kryer nga Komisioni

6.2 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë deklarimi të lidhjes me dhuruesin V.R, mosdeklarim të qëllimit të dhurimit, fshehje dhe deklarim të rremë të subjektit lidhur me dhurimin, pasi rezulton se fëmijët e subjektit zotërojnë sipërfaqe trualli në total 2.000 m² dhe jo një sipërfaqe toke prej 1.000 m², sa është deklaruar nga subjekti.

- 6.3** Për këtë pasuri rezultoi kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 17.10.2014, me palë dhuruese V.R dhe palë pranuese të dhurimit shtetasit L dhe A.H. Dhuruesi është pronar i pasurisë së një sipërfaqeje toke prej 38.000 m², të cilën deklaroi se e ka përfutur nëpërmjet trashëgimisë ligjore. Dhuruesi deklaroi se i dhuron pranuesve të dhurimit pa kundërshpërblim në bashkëpronësi të pandarë mes tyre me nga ½ pjesë, parcelën me sip. 1000 m², nga pasuria e tij me sip. 38.000 m², në ***, Himarë, z. k. ***. Dhurimi do të quhet i përfunduar nga momenti kur nënshkruhet akti i pranimit të dhurimit nga pranuesit e dhurimit dhe regjistrohet në ZVRPP.
- 6.4** Rezultoi se sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të ZVRPP-së Vlorë, regjistri nr. ***, datë 5.2.2015, është regjistruar në emër të shtetasve L dhe A.H pasuria me sip.1000 m², në z. k.***, në vendin e quajtur “****-Himarë”.
- 6.5** Rezultoi se sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të ZVRPP-së Vlorë, regjistri nr. *** datë 5.2.2015, është regjistruar në emër të shtetasve L dhe A.H pasuria me sip.1000 m², në z. k. ***, në vendin e quajtur “****-Himarë”.

Analiza e fakteve

- 6.6** Drejtoria Vendore Vlorë e ASHK-së konfirmon në emër të shtetasve L dhe A.H, të regjistruara parcelat prej 1000 m², sipas regjistrave hipotekore nr. *** dhe nr. **, datë 5.2.2015.
- 6.7** Për këtë pasuri rezultoi edhe mandatdepozitimi bankar në NBG Bank, datë 10.11.2014, i shumës 6.089 lekë (tatim 10% kalim prone) nga pala dhuruese V.R në favor të Degës së Tatim Taksave Vlorë.
- 6.8** Fëmijët e subjektit të rivlerësimit dhe dhuruesi V.R kanë firmosur edhe një deklaratë noteriale nr. ***, datë 18.10.2014, për pranim dhurimi të një sipërfaqeje toke prej 1.000 m², sipas kontratës së dhurimit nr. ***, datë 17.10.2014.
- 6.9** Subjekti është pyetur lidhur me këtë pasuri për të cilën ka kthyer përgjigje sipas pyetësorit nr. 3¹⁰.
- 6.10** Nuk u konstatua konflikt interesi mes subjektit dhe dhuruesit, por mbeti i dyshimtë fakti i dhurimit të sipërfaqes për fëmijët e subjektit, i cili nuk shpjegoi bindshëm marrëdhënien e tij me dhuruesin që është rezident në Greqi.
- 6.11 Komisioni, për këtë pasuri, ka konstatuar se:**
- i. Duket se nga kontratat e dhurimit janë përfutur 2 pasuri me nga 1000 m², pasi rezultojnë 2 deklarata noteriale me fraksione të ndryshme.
 - ii. Subjekti duhet të shpjegojë bindshëm si ka përfutur ai dhe familjarët e tij një sipërfaqe toke (e pretenduar prej 1000 m²) nga një person, i cili nuk është në rrethin familjar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- 6.12** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi se: *“Për sa i përket tokës prej 1000 m² që z. V.R i ka dhuruar 2 fëmijëve të mi, kam dhënë shpjegime dhe nuk është faji im apo i fëmijëve të mi që e kanë regjistruar dy herë këtë dhurim specialistët e zyrës përkatëse në Vlorë. Fëmijët e mi kanë vetëm një certifikatë për tokën*

¹⁰Shihni përgjigjet e pyetësorit të dërguar nga subjekti.

e dhuruar prej 1000 m² dhe, për këtë fakt, nuk ka pse ngrihen dyshime për ndonjë falsifikim të mundshëm sepse tashmë dihen gabimet në zyrën e regjistrimit Vlorë. Gjatë ushtrimit të funksionit tim si prokuror z. V nuk ka pasur asnjëherë ndonjë çështje penale ku unë të kem pasur konflikt interesi me të”.

6.13 Pas shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit shkresor të administruar rezultoi se sipërfaqja e tokës e dhuruar nga shtetasi V.R ishte 1000 m², por Komisioni konstatoi se subjekti nuk shpjegoi bindshëm si është përfituar ky dhurim nga një shtetas i cili nuk ndodhet në rrethin familjar të tij. Pranimi i dhurimit nga një prokuror të një sipërfaqeje të konsiderueshme toke, ndonëse nuk evidentohet ndonjë rast i drejtpërdrejtë i konfliktit të interesit me dhuruesin, cenon besimin e publikut.

6.14 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, duke mos u gjendur në kushtet germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

7. Automjet tip “Mercedes-Benz”

7.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar se në vitin 2008 ka blerë një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa SR *** B, për një vlerë prej 1.000.000 lekësh dhe të regjistruar në DRSHTRR-në Sarandë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.2 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar *mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit dhe mosdeklarim në DPV-në e vitit 2013 të shitjes së automjetit në vlerën 400.000 lekë.*

7.3 Burimi për blerjen e kësaj pasurie është deklaruar kontrata e huas datë 5.12.2008, redaktuar nga noteri me huadhënës shtetasin I.M, me afat 5-vjeçar, me këst 200.000 lekë/vit, e cila nuk është përfunduar plotësisht, pasi është shtyrë me marrëveshje verbale.

Analiza e fakteve

7.4 Nuk rezulton kontratë për blerjen e këtij automjeti, por rezulton një faturë tatimore shitjeje e datës 22.11.2008, në vlerën 667.309 lekë, paguar nga blerësi, subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, rezulton edhe një pagesë e datës 21.9.2008, në vlerën 347.491 lekë, që duket se është për pagim vlere dogane, kryer nga pala shitëse e automjetit.

7.5 Subjekti është pajisur me certifikatë pronësie të automjetit rrugor më 25.2.2009.

7.6 Këtë automjet subjekti ka deklaruar se ia ka shitur shtetasit S.H për shumën 400.000 lekë, për shkak se ka pësuar defekt në motor.

7.7 Rezultoi se me kontratën e shitjes së pasurisë së luajtshme nr. ***, datë 27.5.2013, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur automjetin palës blerëse S.H, në shumën 400.000 lekë.

7.8 Këtë pasuri subjekti e ka deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2008, në vlerën e blerjes 1.000.000 lekë.

- 7.9** DPSHTRR-ja nuk e ka konfirmuar automjetin e mësipërm në pronësi të subjektit për shkak se kjo pasuri është tjetërsuar.
- 7.10** DPPPP-ja ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit në datën 5.12.2008 ka marrë hua shumën 1.000.000 lekë nga huadhënësi I.H.M.
- 7.11** Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2020,¹¹ rezultoi se shtetasi I.M ka pasur xhiro për vitin 2006, në vlerën 3.600.000 lekë. Për vitin 2007 është deklaruar xhiro në bashki dhe për vitin 2008 nuk disponohet informacion.
- 7.12** Rezultoi se me kontratën e huas nr.***, datë 5.12.2008, subjekti i rivlerësimit ka marrë hua nga shtetasi I.M shumën 1.000.000 lekë. Afati i kontratës së huas është 5 vjet dhe përfundon më 4.12.2013. Pagesat për kthimin e huas do të jenë në shumën 200.000 lekë/vit. Në rast mospagimi brenda afatit janë parashikuar edhe sanksionet përkatëse.
- 7.13** Për shlyerjen e detyrimeve të huas për vitet 2008 dhe 2009 është paraqitur deklaratë noteriale nr. ***. Deklaratat për vitet 2008 dhe 2009 që kanë të njëjtin numër regjistrimi përmbajnë korrigjime të vitit dhe, për këtë, i është kërkuar noterit konfirmim. Këto 2 deklarata përcaktojnë se subjekti ka shlyer për vitet 2008-2009 shumën me nga 200.000 lekë çdo vit. Pas përgjigjes së noterit rezultoi se deklarata noteriale ka pasur korrigjim nga noteri dhe se ka qenë një lapsus në datën e deklaratës.
- 7.14** Në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar se ka paguar detyrimet për huan në shumën 200.000 lekë dhe në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar se nuk ka shlyer asnjë shumë për këtë vit dhe pjesa e mbetur pa shlyer është 600.000 lekë.
- 7.15** Subjekti ka paraqitur deklaratat noteriale për vitet 2018 dhe 2019, përkatësisht nr.*** dhe nr. ***, ku rezulton se ka paguar vlerën 400.000 për secilin vit dhe detyrimi është shlyer plotësisht.
- 7.16** Sipas shkresës së tatimeve me nr. *** prot., datë 26.5.2020, vërtetohet xhiroja për vitin 2006, për biznesin në emër të shtetasit I.M, në vlerën 3.600.000 lekë. Subjekti nuk vërteton fitimin *neto* nga biznesi i huadhënësit për të provuar burimin e ligjshëm të huadhënies prej 1.000.000 lekësh.
- 7.17 Komisioni për këtë pasuri ka konstatuar se:**
- i. Subjekti nuk ka provuar mundësinë e huadhënësit I.M për dhënien e huas në vitin 2008, në shumën 1.000.000 lekë. Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues vetëm për xhiron e aktivitetit dhe jo për fitimin *neto*.
 - ii. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për blerjen e automjetit me targa SR *** B, në vitin 2008, në vlerën e deklaruar prej 1.000.000 lekësh.
 - iii. Ka pasaktësi të subjektit në DPV-në e vitit 2010, ku ka deklaruar detyrimin e mbetur palës huadhënëse në shumën prej 600.000 lekësh.
 - iv. Nuk provohet me dokumentacion shkresor revokimi i kontratës së huas apo shlyerja e saj dhe ky fakt i pretenduar ngelet vetëm në kuadrin deklarativ të subjektit.
 - v. Nuk provohet dhe argumentohet nga subjekti pse një kontratë e lidhur e huas me afat shlyerje deri në vitin 2013 nuk është zbatuar, nëse janë ekzekutuar penalitetet

¹¹Shihni shkresën e DRT-së në përgjigje të pyetësorit nr. 3 nga subjekti.

përkatëse të vendosura në këtë kontratë edhe pse detyrimi është deklaruar i shlyer në vitet 2017 dhe 2018.

- vi. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 – 2016 detyrimin e mbetur ndaj huadhënësit I.M.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- 7.18** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Në vitin 2008 është deklaruar në DPV kthimi i huas në shumën 200.000 lekë. Diferenca e huas në shumën prej 800.000 lekë është shlyer me vonesë në vitet 2017 dhe 2018 sepse huadhënësi nuk ka pasur nevojë”*.

Subjekti, në prapësime, sqaron se e vlerëson të gabuar që Komisioni llogarit si detyrime edhe ato penalitete që nuk i janë kërkuar dhe as janë paguar. Z. I.M ka pasur biznes privat (2 dyqane mishi në Durrës dhe Kavajë) dhe, si i tillë, kishte mundësi t'i jepte hua shumën 1.000.000 lekë.

- 7.19** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni.
- 7.20** Komisioni nuk i ka llogaritur subjektit detyrimet lidhur me penalitetet, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me deklaratimet kontradiktore të bëra prej tij në DPV-të lidhur me shlyerjen e detyrimit.
- 7.21** Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion provues lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit në shumën prej 1.000.000 lekësh, në vitin 2008, në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.
- 7.22** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- 7.23** Mosvërtetimi i mundësisë së huadhënies për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” sjell mosnjohjen e ligjshmërisë së të ardhurave nga shitja e këtij automjeti në vitin 2013, në vlerën 400.000 lekë.

8. Automjet tip “Peugeot”

- 8.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në datën 23.1.2012, ka blerë nga shtetasi A.G automjetin tip “Peugeot 106” për vlerën 500 euro, të cilën e ka regjistruar me targa AA *** CN dhe më pas, në datën 6.2.2012, ia ka shitur shtetasit B.M për shumën 2.200 euro. Gjendje: 1.700 euro. Kontratat dhe dokumentacioni bashkëlidhur.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 8.2** Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti e ka blerë dhe shitur automjetin brenda një periudhë 2-javore, për të cilën ka paguar edhe detyrimet doganore, por në DPV-në e vitit 2012 nuk është deklaruar shitja e kësaj pasurie.

Analiza e fakteve

- 8.3** Për këtë pasuri rezultoi një deklaratë shitjeje greke datë 23.1.2012, me palë shitëse A.G dhe palë blerëse Sali Hasa, e përkthyer, por nuk përcaktohet vlera.
- 8.4** Subjekti i rivlerësimit, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.2.2012, ia ka shitur këtë automjet shtetasit B.M, në shumën 2.200 euro.
- 8.5** Pas blerjes, subjekti i rivlerësimit është pajisur me leje qarkullimi për automjetin me targa AA *** CN. Kjo është konfirmuar dhe nga certifikata e pronësisë së automjetit rrugor tip “Peugeot”, me targa AA *** CN, në emër të subjektit të rivlerësimit.
- 8.6** Subjekti është pyetur për të sqaruar mosdeklarimin e blerjes së automjetit në DPV-në e vitit 2012 dhe për diferencën e çmimit nga blerja e deklaruar prej 500 euro në shitjen për disa ditë në vlerën 2.200 euro.
- 8.7** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ka qenë një okazion në blerje dhe në shitje më pas dhe se periudha nga blerja në shitje ka qenë e shkurtër, brenda 2 javëve.
- 8.8** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se nuk ka paguar tatim mbi fitimin për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve.
- 8.9** Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Peugeot” më 23.1.2012, në vlerën 500 euro

Të ardhura Sali Hasa deri më 23.1.2012	90,504
Të ardhura M.H deri më 23.1.2012	44,305
Të ardhura totale deri më 23.1.2012	134,809
Shpenzime jetese deri më 23.1.2012	25,827
Shpenzime për kredinë deri më 23.1.2012	17,628
Shpenzime për vajzën dërguar me bankë deri më 23.1.2012	30,000
Shpenzime mobilimi shtëpia në Sarandë	7,640
Shpenzime arsimimi në Rusi deri më 23.1.2012	58,333
Blere automjet tip “Peugeot” datë 23.1.2012	69,860
Shpenzime totale	209,289
Ndryshim likuiditetesh 31.12.2011 – 23.1.2012	21,930
Pamundësia financiare	-96,410

8.10 Komisioni për këtë pasuri ka konstatuar se:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar në DPV blerjen e automjetit tip “Peugeot”.
- ii. Pas hetimit mbeti i dyshimtë fakti i blerjes së kësaj pasurie në vlerën 500 euro dhe shitjen më pas në vlerën 2.200 euro.
- iii. Nuk disponohet kontratë blerjeje e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit për të provuar vlerën e blerjes prej 500 euro.
- iv. Vërehet një çmim preferencial në vlerën e blerjes së kësaj pasurie nga ana e subjektit.

- v. Bazuar në analizën financiare, subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë pasurinë automjet tip “Peugeot”, shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera deri më 23.1.2012.
- vi. Në analizën financiare vlera e përfituar nga shitja e automjetit tip “Peugeot” nuk është përfshirë për arsye se nuk është vërtetuar burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.11 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar¹² se: *“Automjetet tip “Mercedes-Benz” me targa SR *** B, “Peugeot”, “Audi” dhe “Volkswagen” kanë qenë të përdorura dhe si mallra konsumi në qarkullimin civil dhe çmimet e tyre kanë qenë të momentit sipas kërkesës dhe ofertës. E rëndësishme është që asnjëherë ato nuk janë bërë pa dokumente zyrtare dhe janë transaksione të bëra me persona që nuk kanë pasur konflikte interesi me mua si prokuror”.*

Subjekti, në prapësime, sqaron se Komisioni kur ngre dyshime për çmimet e blerjes apo shitjes nuk bën të ditur se mbi bazën e cilave standarde i ngre dyshimet kur nuk merr parasysh vitet e prodhimit të automjeteve (vjetërsinë), rastet e shtesës së vlerës për shkak të riparimeve kapitale që ia rritin vlerën automjetit etj.

9. Automjet tip “Audi A4”

9.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e pasurisë automjet tip “Audi”, në vlerën 850 euro dhe shitjen më pas djalit të tij në vlerën 1.000 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni

9.2 Për këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar se lindin dyshime lidhur me çmimin e rritur të shitjes së automjetit tip “Audi A4” nga djali i subjektit në harkun kohor të 2 viteve.

Analiza e fakteve

9.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me faturën e datës 12.7.2012 ka blerë nga shtetasi A.P automjetin tip “Audi A4” për vlerën 850 euro.

9.4 Për këtë automjet nuk disponohet kontratë shitjeje, por një faturë me nr. ***, datë 12.7.2012, e përkthyer dhe e noterizuar, ku rezulton vlera 850 euro në emër të subjektit të rivlerësimit nga shtetasi A.P, për shitjen e këtij automjetit me targa AR *** ET.

9.5 Pas targimit subjekti ia ka kaluar automjetin djalit L.H, me anë të kontratës së shitjes, për vlerën 1.000 euro.

9.6 Për këtë pasuri rezultoi kontrata e shitjes nr. ***, datë 19.7.2012, me palë shitëse subjekti i rivlerësimit, dhe palë blerëse L.H, në vlerën 1.000 euro.

9.7 Për këtë automjet është plotësuar edhe një deklaratë doganore, ku konfirmohet pagesa prej 34.400 lekësh për zhdoganimin e tij. Pagesa e detyrimeve doganore është bërë nga subjekti i rivlerësimit më anë të mandatarkëtimit pranë “Emporiki Bank”, në datën 17.7.2012, me përshkrimin “pagesë për degën Dogana Durrës, në shumën 34.400 lekë”.

9.8 Më pas ky automjet është shitur me kontratën e shitjes nr. ***, datë 15.9.2014, me palë shitëse L.H dhe palë blerëse A.A, në shumën 400.000 lekë.

¹²Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit në dosjen e Komisionit.

- 9.9** DPSHTRR-ja nuk e konfirmon këtë automjet në pronësi të subjektit dhe as të djalit të tij.
- 9.10** Subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me këtë pasuri, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se automjeti është blerë në vlerën 850 euro, për të cilin janë paguar detyrimet doganore, e më pas i është shitur djalit të tij në vlerën 1.000 euro. Pas 2 viteve, për shkak të gjendjes shumë të mirë automjeti, është shitur në vlerën 400.000 lekë.
- 9.11** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se nuk ka paguar tatim mbi fitimin për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve.
- 9.12** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* nga shitja e këtij automjeti, ndërkohë, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë, që kanë si burim shitjen e automjetit tip “Audi”, me targa AA *** EB, në vitin 2014, me shitës djalin e tij L.H dhe blerës shtetasin A.A.
- 9.13** Në analizën financiare nuk është përfshirë ndonjë gjendje kursimesh *cash* për vitin 2014, pasi nuk është deklaruar në deklaratën periodike përkatëse. Në vitin 2015 përfshihet vlera prej 400.000 lekësh e deklaruar nga subjekti.
- 9.14** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 deklarohet blerja e një automjeti tip “Volkswagen”, në vlerën 200.000 lekë, me burim kursimet *cash* nga të ardhurat e shitjes së automjetit tip “Audi” në vitin 2014.
- 9.15** Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Audi” në datën 17.7.2012, në vlerën 850 euro + 34.297 lekë

Të ardhura Sali Hasa, periudha 24.1.12 – 17.7.2012	458,330
Të ardhura M.H, periudha 24.1.12 – 17.7.12	274,906
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, datë 6.2.2012	0
Të ardhura totale, periudha 24.1.2012 – 17.7.2012	733,236
Shpenzime jetese, periudha 24.1.12 – 17.7.12	261,653
Shpenzime për kreditë, periudha 24.1.2012 – 17.7.2012	112,256
Shpenzime për vajzën dërguar me bankë, periudha 24.1.2012 – 17.7.2012	290,000
Shpenzime mobilimi për shtëpinë në Sarandë, periudha 24.1.2012 – 17.7.2012	45,840
Shpenzime arsimimi në Rusi, periudha 24.1.2012 – 17.7.2012	291,667
Shpenzime udhëtimi 24.1.2012 – 17.7.2012	167,664
Blere automjet tip “Audi”, datë 17.7.2012	151,742
Shpenzime totale	1,320,821
Ndryshim likuiditetesh, periudha 24.1.2012 – 17.7.2012	136,602
Pamundësia financiare	-724,187

Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Peugeot” nuk janë konsideruar nga Komisioni si burim për blerjen e automjetit tip “Audi”, pasi nuk është vërtetuar burimi i ligjshëm i blerjes së mjetit “Peugeot”.

- 9.16** Komisioni, për këtë pasuri, ka konstatuar se:

- i. vlera e automjetit të blerë në vitin 2012 në shumën 850 euro është me çmim preferencial;
- ii. pas hetimit mbeti i dyshimtë fakti i blerjes së kësaj pasurie në vlerën 850 euro në vitin 2012 dhe shitjen në vlerën 400.000 lekë në vitin 2014;
- iii. nuk disponohet kontratë blerjeje e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit për të provuar vlerën e blerjes prej 850 euro;
- iv. bazuar në analizën financiare subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë pasurinë automjet tip “Audi”, shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera deri në datën 17.7.2012;
- v. në analizën financiare vlera e përfituar nga shitja e automjetit tip “Audi” nuk është përfshirë tek të ardhurat në analizën financiare të vitit 2014, pasi nuk është vërtetuar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie.

9.17 Subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si për pasurinë e përmendur në pikën 8.11 të këtij vendimi.

10. Automjet tip “Volkswagen”

10.1 Djali i subjektit L.H ka deklaruar në deklaratën *Vetting* blerjen e automjetit tip “Volkswagen” në vitin 2016, në vlerën 200.000 lekë, për të cilin janë bërë riparime në vlerën 100.000 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

10.2 Rezultoi se në kontratën e shitjes nr. ***, datë 16.1.2016, djali i subjektit ka blerë nga pala shitëse E.L automjetin tip “Golf”, në vlerën 200.000 lekë.

10.3 Burimi është deklaruar nga të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Audi A4”. Komisioni nuk e ka konsideruar vlerën prej 400.000 lekësh, të deklaruar si burim nga djali i subjektit, si të ardhur të ligjshme në vitin 2014, kur është bërë shitja. Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 këto të ardhura nga shitja e automjetit tip “Audi A4” nuk janë deklaruar nga subjekti as si kursime *cash*.

10.4 Komisioni për këtë pasuri ka konstatuar se:

- i. Rezultoi i dyshimtë çmimi i blerjes së automjetit në raport me vlerën e tregut, si dhe burimi për blerjen e tij.
- ii. Në analizën financiare automjeti është vlerësuar në vlerë totale 300.000 lekë, duke përfshirë çmimin e blerjes dhe shpenzimet e deklaruara për riparime mbi automjetin.
- iii. Pas hetimit nga Komisioni, mbeti i pavërtetuar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie.

10.5 Subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si për pasurinë e përmendur në pikën 8.11 të vendimit.

10.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni.

10.7 Konstatimet e Komisionit janë për të tria pasuritë automjete të përmendura në pikat 8.9 dhe 10 të vendimit. Subjekti nuk paraqiti prova dhe argumente bindëse lidhur me mosdeklarimet e pasurisë automjet, mungesën e kontratave të blerjes, pamundësinë financiare për krijimin e tyre, si dhe çmimin preferencial të përfitimit, duke i shitur me vlerë më të madhe se vlera e blerjes.

10.8 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pasuritë e luajtshme automjete, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Konstatime të tjera

11. Shpenzimet e arsimit të fëmijëve të subjektit në Rusi

- 11.1** Referuar dokumenteve të përcjella nga subjekti në përgjigje të pyetëson¹³, në analizën financiare janë llogaritur vetëm shpenzimet e jetesës dhe jo ato të arsimit, nga ku subjekti i rivlerësimit pretendon se arsimiti i tyre është kryer falas me mbështetjen e shtetit shqiptar dhe atij rus.
- 11.2** Në analizën financiare, shpenzimet e jetesës së fëmijëve të subjektit në Rusi janë vënë sipas deklarameve që janë bërë në përgjigjet e pyetësonëve dhe dokumenteve që vërtetojnë transfertat e parave (Western Union) nga subjekti në favor të fëmijëve.
- 11.3** Subjekti deklaron se për vitet shkollore 2003 - 2004 dhe 2004 - 2005 gjyshërit i kanë dhënë *cash* fëmijëve vlerën 500.000 lekë për çdo vit shkollor për të mbuluar shpenzimet e jetesës. Përveç këtyre shumave, subjekti ka dërguar vlera monetare me Western Union, të cilat përfshihen si shpenzime jetese për fëmijët në këtë periudhë.
- 11.4** Në përgjigje të pyetësoni, subjekti ka deklaruar se *nga viti 2006 e deri në fund të studimeve shpenzimet e jetesës së fëmijëve në Rusi kanë qenë në masën 700.000 lekë në vit. Ato mbulohehin nga depozita e lënë nga gjyshi i tyre pas vdekjes, të cilën e kishte tërhequr daja i fëmijëve Q.D dhe nga dërgesat që subjekti dhe bashkëshortja i kanë bërë fëmijëve.* Në analizën financiare për periudhën shkollore 2006 – 2012, shpenzimet e jetesës së fëmijëve në Rusi janë vlerësuar në masën 700.000 lekë/vit, si dhe dërgesat me Western Union që ka bërë subjekti.
- 11.5** Për pjesën e vitit kur fëmijët e subjektit kanë qenë në Shqipëri, shpenzimet e jetesës janë vendosur sipas standardit të zbatuar nga Komisioni, të plotëpjesëtuar me muajt e qëndrimit në Shqipëri.
- 11.6** Subjekti ka bërë deklaram të ndryshme lidhur me shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për fëmijët në Rusi.
- i. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2014 ka transferuar përmes Western Union për fëmijët për studime shumë prej 7.880 euro.
 - ii. Në përgjigje të pyetësonit standard subjekti ka deklaruar se për të përballuar jetesën e fëmijëve ka pasur shpenzime që kapin vlerat 11.800 euro dhe 500 euro.
 - iii. Në përgjigje të pyetësonit nr. 3, subjekti ka deklaruar se së bashku me bashkëshorten kanë transferuar nëpërmjet Unionit Financiar shumë prej 7.880 euro nga kursimet nga pagat e tyre.

¹³Vërtetim nr. *** prot., datë 15.1.2020, i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme; vërtetim nr. *** prot., datë 13.1.2020, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

11.7 Pas hetimit, Komisioni ka konkluduar se:

- i. Ka mospërputhje deklarimesh lidhur me shpenzimet e kryera të fëmijëve gjatë shkollimit në Rusi.
- ii. Në analizën financiare, shumat e deklaruara nga subjekti si kontribute të gjyshërve, për shkollimin e fëmijëve në Rusi, nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme. Kjo për faktin se subjekti nuk i ka deklaruar asnjëherë këto dhurime dhe as burimet e tyre në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *Vetting*.

11.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni. Siç ka shpjeguar edhe në lidhje me mundësinë financiare për krijimin dhe përdorimin e depozitës prej 2.500.000 lekësh nga puna e bashkëshortes në biznesin e babait të saj Z.D, subjekti i rivlerësimit thekson faktin se gjyshërit dhe daja i fëmijëve kanë kontribuar në shkollimin e fëmijëve në Rusi, por pa provuar mundësitë financiare të tyre për përballimin e këtyre shpenzimeve.

11.9 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për përballim e shpenzimeve të arsimimit të fëmijëve, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

12. Pasuritë në përdorim

12.1 Subjekti ka deklaruar se për periudhën korrik 2003 – janar 2005 ka përdorur apartamentin e ndodhur në rrugën “***”, në Sarandë, pa kundërshtpërblim, i cili ka qenë në pronësi të shtetasit P.S (blerë në vitin 2000).

12.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për periudhën janar 2005 - qershor 2010 ka përdorur apartamentin e ndodhur në rrugën “***”, në Sarandë, pa kundërshtpërblim, i cili ka qenë në pronësi të shtetasit A.Xh.

12.3 Subjekti ka deklaruar se ka në përdorim një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa AA *** ER, prodhim i vitit 2001, që nuk është regjistruar në emrin e tij, të cilin e deklaruar si të marrë në provë nga shtetasi D.A, banues në Lagjen Nr. ***.

12.4 Vajza e subjektit ka deklaruar se ka në përdorim një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa AA *** LL, në pronësi të shtetasit E.Gj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

12.5 Komisioni e konstatoi të dyshimtë faktin se subjekti ka përdorur apartamentin në rrugën “***”, për gati 2 vjet, 5 vjet apartamentin në rrugën “***”, pa kundërshtpërblim, dhe pasurinë automjet, për të cilat kreu hetim administrativ.

12.6 Përdorimi i këtyre pasurive nga subjekti për disa vite, pa kundërshtpërblim, u konsiderua i dyshimtë nga Komisioni.

12.7 Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar se ndër vite ka pasur në përdorim apartamentin në pronësi të shtetasve P. S. dhe A. Xh. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezultoi se këto pasuri të paluajtshme ishin në emër të personave të deklaruar nga subjekti.

12.8 Pasuritë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa AA *** ER dhe automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa AA *** LL, rezultuan me mungesë dokumentacioni ligjor për përdorimin e tyre, si dhe lidhur me pronësinë dhe afatet kohore të marrjes/dorëzimit.

12.9 Për të gjitha gjetjet dhe konstatimet e mësipërme lidhur me pasuritë në përdorim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

12.10 Subjekti ktheu përgjigje¹⁴ lidhur me këto konstatime të Komisionit.

12.11 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti argumente bindëse lidhur me përdorim e këtyre pasurive në përdorim, pa kundërshtpërblim, ndër vite. Veprime të tilla për Komisionin, pavarësisht mospasjes në dukje të konfliktit të interesit, cenojnë figurën e gjyqtarit dhe humbin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

13. Dhurime

13.1 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se ka pranuar dhurim nga shtetasit J dhe M.B, i cili ka qenë në formën e përballimit të shpenzimeve për një udhëtim në Moskë në vitin 2006.

13.2 Ky dhurim nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 dhe atë *Vetting* dhe as sa ka qenë shuma e dhuruar.

13.3 Për më tepër, në DPV-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar se *nuk ka dhënë dhe nuk ka marrë asnjë dhuratë*.

13.4 Për Komisionin mbetet i dyshimtë lidhja e subjektit me këta shtetas, shuma e dhuruar, si dhe ky dhurim nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti në deklaratat e pasurisë.

13.5 Për të gjitha gjetjet dhe konstatimet e mësipërme lidhur me pasuritë në përdorim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13.6 Subjekti ktheu përgjigje¹⁵ lidhur me këto konstatime të Komisionit.

13.7 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti argumente bindëse lidhur me këtë dhurim. Veprime të tilla për Komisionin, pavarësisht mospasjes në dukje të konfliktit të interesit, çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe humbin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

14. Çështje të tjera

14.1 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti kërkoi pezullim të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj tij.

14.2 Kërkesës së subjektit së rivlerësimit *për pezullim të procedurës së rivlerësimit deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata penale ose deri në lirim fizik të*

¹⁴Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit në dosjen e Komisionit.

¹⁵Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit në dosjen e Komisionit.

subjektit të rivlerësimit Sali Hasa, Komisioni iu përgjigj se kjo kërkesë nuk merret në konsideratë sepse procesi administrativ i rivlerësimit kalimtar nuk lidhet dhe nuk është në varësi të procesit penal që po zhvillohet ndaj tij.

- 14.3** Gjithashtu, kërkesës së subjektit të rivlerësimit *për marrje provash dhe pyetje të dëshmitarëve “për të mbyllur hamendësimet dhe dyshimet e Komisionit” për disa nga çështjet në procesin e rivlerësimit, pavarësisht paraqitjes së dokumentacionit, Komisioni nuk e pranoi këtë kërkesë, në referim të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurave Administrative, ku thirrja e dëshmitarëve është e nevojshme kur dokumentet janë zhdukur, humbur ose kur nuk mund të merren përsëri. Por kur aktet ekzistojnë dhe kur për të cilat nuk pretendohet se janë të falsifikuara, ato përbëjnë provë në kuptim të ligjit.*

Në këto kushte, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka sjellë dokumentacion provues ndaj pretendimeve të tij, si dhe për sa kohë Komisioni i ka konsideruar në kufijtë e vërtetësisë dhe jo të vlefshmërisë ligjore të tyre si akte në kuptimin administrativ, nuk mund të pranohej kërkesa për pyetje dëshmitarësh, kur këta të fundit nuk do të deklaronin diçka tjetër, përpos atyre të paraqitura me dokumente shkresore nga subjekti i rivlerësimit.

Analiza financiare

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: SALI R. HASA																
	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	10,167,168	0	2,500,000	-1,535,516	256,141	365,837	1,334,139	619,307	2,358,872	436,443	584,520	351,833	-1,027,563	444,239	415,152	7,103,402
Apartament 1+1 Kavaje - Sali Hasa - 1993 - 100%	13,268															0
Truall 500 m2 Kavaje - 1998 - Sali Hasa - 100%	500,000															0
Banese karabina 130 m2 Kavaje	3,624,140															0
Apartament 163.28 m2 Durrës -50,000 \$ - Sali Hasa - 100%	6,029,760			619,980												619,980
Apartament 90 m2 Sarandë - M. H. - 2010 -100%									3,960,000							3,960,000
Toke kullote 1.000 m2 ***; Himare dhuruar - 2014 - L.H. + A. H. - 50%																0
Autoveture Benz SR***B - 2008 - Sali Hasa - 100%							1,000,000									1,000,000
Autoveture Peugeot AA***CN - 2012 - Sali Hasa - 100%											69,860					69,860
Autoveture Audi A4 - 2012 - L. H. - 100%											151,742					151,742
Autoveture Opel Corsa - AA***EY - A. H. 100%											125,748					125,748
Autoveture Volkswagen Golf - 200.000 leke - 2016 - L. H. - 100%															300,000	300,000
Autoveture Ford AA***AE - 200.000 leke - 2013 - A. H. - 100%												200,000				200,000
Ndryshim ne likuiditet		0	2,500,000	-2,155,496	256,141	365,837	334,139	619,307	-1,601,128	436,443	237,170	151,833	-1,027,563	444,239	115,152	676,073
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	3,168,000	-21,355	-55,998	-186,291	172,733	-430,952	-134,777	2,511,359
Kredi BKT 3.168.000 leke - M.H. + L. H. - 2011										3,078,645	-118,798	-123,491	-127,267	-130,952	-134,777	2,443,359
Kredi Raiffeisen - 62.800 leke - 2012											62,800	-62,800				0
Kredi personale Raiffeisen - 300.000 leke - Sali Hasa - 2014													300,000	-300,000		0
Detymir per apartament 90 m2, Sarandë M. H. - 3.960.000 leke - 2010 - 2011									3,168,000	-3,100,000						68,000
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	10,167,168	0	2,500,000	-1,535,516	256,141	365,837	1,334,139	619,307	-809,128	457,798	640,518	538,124	-1,200,296	875,192	549,928	4,592,043
TE ARDHURA dokumentuar	2,209,453	821,402	1,293,728	1,057,993	1,446,197	1,480,751	1,965,861	1,307,416	1,361,131	1,603,168	1,537,206	2,138,531	2,736,137	2,531,699	2,724,273	27,774,786
Te ardhura nga shitja apartament Kavaje blere ne 1993 - 1.500.000 leke	1,500,000															1,500,000
Te ardhura nga shitja e tokes are 500 m2 blere ne 2001 - 500.000 leke - 2004			500,000													500,000
Te ardhura nga shitja e automjetit Opel Corsa AA***EY - 2014													126,099			126,099
Te ardhura nga shitja e automjetit Ford AA***AE - 3.000€ - 2016 - A. H.															200,000	200,000
Te ardhura nga vendimi I Gjykeses TR per paga qendrim ne dispozicion 2003-2004							349,170									349,170
Te ardhura nga interese bankare Alpha Bank & Raiffeisen Bank & BKT							65,376	97,251	27,914			42,313				232,854
Te ardhura nga puna L. H.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	253,550	500,385	501,635	478,517	1,734,087
Te ardhura nga puna A.H.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	264,125	265,500	38,500	223,168	791,293
Te ardhura nga puna subjekti Sali Hasa	2,010,385	605,523	533,317	757,488	1,129,254	1,109,902	1,084,428	657,445	810,000	1,032,656	958,814	1,028,519	1,283,429	1,408,100	1,394,598	15,803,857
Te ardhura nga puna bashkeshortja M.H.	258,909	215,879	260,411	300,505	316,943	370,849	466,887	552,720	523,217	570,512	578,392	550,024	560,724	583,464	427,990	6,537,426
SHPENZIME	1,066,881	594,535	1,098,323	1,265,352	1,917,354	1,623,330	1,662,409	1,627,511	1,890,520	1,890,415	1,829,632	1,409,260	2,050,444	1,382,377	1,385,941	21,627,401
Shpenzime jetese	918,746	344,535	297,553	346,931	310,412	318,780	318,780	352,935	375,705	364,320	488,418	564,096	879,992	897,104	940,368	7,718,673
Shpenzime per vajzen A. H. derguar me banke										120,000	540,001	623,001	370,001	360,001	360,001	2,373,005
Shpenzim per blerje pajisje pastrimi - 1.790€ - 2014													250,797			250,797
Shpenzime konvikti dhe ushqimi femijet ne Rusi dhene nga gjysherit		250,000	500,000	500,000	600,000	700,000	700,000	700,000	700,000	700,000	350,000					5,700,000
Shpenzime per studime L.H. dhe A. H. ne Rusi derguar nga subjekti			224,726	208,318	210,295	120,910	492,730		277,620							1,534,599
Shpenzim dhene I. M. - 2009								200,000								200,000
Shpenzime per sigurime vullnetare M. H.	148,135															148,135
Shpenzime interesi +disbursim + sig kredi BKT - 2011 - M.H. dhe L. H.										118,090	102,109	97,260	99,366	89,826	85,572	592,223
Shpenzime interesi kredi Raiffeisen - 2014 - Sali Hasa - 300.000 leke														13,422		13,422
Shpenzime per pajisje elektrike + shpenzime interesi per kredine Raiffeisen - 2012											59,800	267				60,067
Shpenzime mjekesore								26,164								26,164
Shpenzime per taksa makine										26,964	29,960	32,956				89,880
Shpenzime per blerje elektroshtepiake per apartamentin ne Sarandë													300,000			300,000
Shpenzime mobilimi shtepia Sarandë 2011 - 2014 - 275.000 leke										53,480	91,680	91,680	38,200			275,040
Shpenzime udhetime			76,044	210,103	796,647	483,640	150,899	348,412	259,575	230,961	167,664	0	112,088	22,024	0	2,858,056
Shpenzime qiraje ne Sarandë - 2010 - 2011									277,620	276,600						554,220
Analiza dokumentuar	-9,024,596	226,867	-2,304,595	1,328,158	-727,298	-508,416	-1,030,686	-939,402	279,739	-745,045	-932,944	191,147	1,885,989	274,130	788,404	-11,238,547
																Pamundesia financiare
																-16,212,981

Nga analiza financiare duket se subjekti ka rezultuar në një pamundësi financiare, në total në shumën 15.212.981 lekë.

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

- a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë: “Credins Bank”, “Raiffeisen Bank”, BKT, “Intesa Sanpaolo Bank”, “Alpha Bank”, “Union Bank”, OTP Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.
- b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:
 - i. të ardhurat nga pagat e subjektit në: Drejtorinë e Policisë Berat (viti 1991); Drejtorinë e Policisë Kavajë dhe Tiranë (vitet 1991 - 1992); në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë (vitet 1995 - 1998), si përmbarues; Policinë Vendore Durrës (vitet 1998 - 2000), si oficer; Drejtorinë Vendore të Policisë Fier (vitet 2000 - 2001), si shef i policisë kriminale; Komisariatin e Policisë Sarandë (vitet 2001 - 2002), si shef i Komisarariatit të Policisë Sarandë; Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë (viti 2002); Komisariatin e Policisë Peqin (vitet 2002 - 2003) si shef; të ardhura nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për paga për qëndrim në dispozicion (vitet 2003 - 2004); dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë (vitet 2004 - 2016), si prokuror;
 - ii. të ardhurat nga pagat e bashkëshortes të subjektit nga OSHEE-ja (vitet 2001 - 2016);
 - iii. të ardhurat nga puna e djalit të subjektit nga: shoqëria “****” (vitet 2013); Drejtoria e Punësimit të Qarkut Durrës (vitet 2013 - 2016); Qendra e Karrierës, Universiteti i Tiranës (viti 2016), si specialist;
 - iv. të ardhurat nga puna e vajzës së subjektit: si sekretare e kryetarit të Këshillit Drejtues në AKEP (viti 2013); dëshmëpërblim nga AKEP-i (viti 2014); si specialiste në KQZ (viti 2015); si specialiste tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (viti 2016);
 - v. të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kavajë (viti 1998), si dhe të ardhurat nga shitja e tokës arë (viti 2004);
 - vi. të ardhurat nga shitja e automjeteve tip “Opel Corsa” dhe “Ford”; si dhe
 - vii. të ardhurat nga interesat bankare në BKT dhe “Alpha Bank”.
- c. Shpenzimet, ku përfshihen:
 - i. shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum, sipas përbërjes familjare (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i);
 - ii. shpenzime udhëtimi, për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS* – për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.), datë 22.5.2015, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrimi pranë të afërmeve;
 - iii. shpenzime mobilimi dhe blerje elektroshtëpiake për shtëpinë në Sarandë, të deklaruara nga subjekti (vitet 2011 - 2014);

- iv. shpenzime interesash, principali dhe shpenzime të tjera të lidhura me kreditë në BKT dhe “Raiffeisen Bank”;
Lidhur me huan e deklaruar si të marrë nga shtetasi I.M, ajo nuk përfshihet në analizën financiare si të vitit 2008 dhe kthimi i një pjese prej saj në vlerën 200.000 lekë në vitin 2009 është përfshirë si shpenzim. Subjekti nuk dokumentoi fitimin *neto* nga biznesi i huadhënësit;
 - v. shpenzim për dërgesat apo depozitimet në llogarinë e vajzës nga subjekti (vitet 2011 - 2016), vërtetuar nga *statement*-i bankar i “Raiffeisen Bank”;
 - vi. shpenzime për blerje pajisjesh pastrimi (viti 2014) dhe pajisjesh elektrike (viti 2012);
 - vii. shpenzime arsimimi dhe akomodimi për fëmijët në Rusi (vitet 2003 - 2012);
 - viii. shpenzime për sigurimin vullnetar të bashkëshortes së subjektit dhe shpenzime mjekësore të deklaruar nga subjekti (viti 2009);
 - ix. shpenzime për qira (vitet 2010 - 2011), sipas kontratës së qirasë; si dhe
 - x. shpenzime për taksa automjeti.
- d. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁶.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kritereve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Sali Hasa, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave private, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe përdorim.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si prokuror.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë, ka rezultuar se:

- a. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1997 – 2016.
- b. Ka bërë deklaram të pasaktë dhe të rremë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm.

¹⁶Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

- c. Ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- d. Ka kryer veprime dhe mosveprime që cenojnë figurën e magjistratit dhe humbin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Sa më sipër, rezulton se në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Sali Hasa, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Roland ILIA
Relator

Ertugena Sokoli/Amela Idrizi
Sekretare gjyqësore